

<p style="text-align: center;">DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</p>	<p style="text-align: center;">SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</p>	<p style="text-align: center;">POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</p>
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

ASC – 10 – 0002

Në padinë e

Ankuesi/ Apeluesi

[REDACTED], 18000 Nish

kundër

E Paditura

Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit

Përfaqësuar nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut
Kompleksi TSS, Prishtinë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Ejja-Liisa Helin, Gjyqtarë, pas seancës vendim marrëse të mbajtur më 8 mars 2010, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet ankesa si e pabazë dhe vërtetohet aktvendimi i Trupit Gjykses të DHPGJS-së në lëndën SCEL-06-020 të datës 24 nëntor 2009.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Më 24 dhjetor 2009, Trupi Gjykses i DHPGJS-së mori një aktvendim në lëndën SCEL-06-020 duke e "hedhur poshtë" ankesën e Ankuesit/Apeluesit. Trupi Gjykses theksoi se Ankuesi ka kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime të Ndërmarrjes Shoqërore "[REDACTED]" në Ferizaj. Paraprakisht Ankuesi kishte ushtruar një ankesë të njëjtë më 4 gusht 2006 pranë DHPGJS-së lidhur me të njëjtën çështje dhe DHPGJS-ja e kishte marrë një aktvendim të formës së prerë më 31 janar 2007 me të cilin e refuzoi

ankesën. Në pajtim me nenin 70.3 të Urdhëresës Administrative (UA) të UNMIK-ut 2008/6 dhe paragrafi 2 i nenit 333 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Trupi Gjykses i DHPGJS-së 'hodhi poshtë' ankesën "pasi që është res judicata".

Më 6 janar 2010, Ankuesi e ushtroi një ankesë kundër aktvendimit të lartpërmendur duke kërkuar nga Kolegji për Ankesa të DHPGJS-së ta ndryshojë aktvendimin dhe ta obligojë Agjencinë Kosovare të Privatizimit t'ia paguajë atij 20 për qind nga të ardhurat nga privatizimi të NSH-së [REDACTED] [REDACTED] "përfshirë kamatën që nga dita e privatizimit deri në ditën e pagesës". Ankuesi/Apeluesi pohon se ai ka qenë i punësuar në ndërmarrjen e përmendur që nga 10 shkurti 1960 deri më 16 qershor 1999, kur është detyruar ta lëshojë punën dhe vendbanimin. Më 31 janar 2007, në kohën e privatizimit të NSH-së, ai veç e kishte kaluar moshën prej 65 vitesh e caktuar për marrjen e pensionit, por ai nuk e dinte se pse ky fakt ka rëndësi në përfshirjen apo mos-përfshirjen e tij në listën e punëtorëve me të drejta legjitime.

Arsyetimi Ligjor:

Ankesa është e pranueshme, por e pabazuar. Në bazë të nenit 63.2 të UA-së të UNMIK-ut 2008/6, Kolegji i Ankesave vendosi që ta refuzojë pjesën gojore të procedurës.

Ashtu siç është theksuar nga Trupi Gjykses, DHPGJS-ja përmes aktgjykimit të datës 31 janar 2007 veç ka vendosur për ankesën e Ankuesit lidhur me të njëjtën lëndë dhe që kërkon të njëjtën zgjidhje: të përfshihet në listën e punëtorëve me të drejta legjitime të NSH-së [REDACTED], të cilët kanë të drejtë në 20 për qind të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së. Kjo duhet të merret parasysh nga gjykata ex officio. Në pajtim me paragrafin 2 të nenit 333 të Kodit të Procedurës Civile, Gazeta Zyrtare 4/77-1478 et al e RSFJ-së ("Ligji mbi Procedurën Kontestimore") ankesa e Ankuesit në të njëjtën lëndë hidhet poshtë si e papranueshme. Konkludimi i Trupit Gjykses është i drejtë.

Prandaj, u vendos si në dispozitiv.

Richard Winkelhofer,

_____ nënshkruar _____

Gjyqtar Kryesues e EULEX-it

Torsten Frank Koschinka,
Gjyqtar i EULEX-it

nënshkruar

Ejia-Lisa Helin,
Gjyqtare e EULEX-it

nënshkruar

Tobias Lapke,
Regjistruer i EULEX

nënshkruar